

## Fjala e ministrit të Financave z. Ridvan Bode në takim

Të nderuar pjesëmarrës!

Përfaqësues të siguruesve, të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare e të tjerë pjesëmarrës në këtë takim pune.

Ne jemi mbledhur sot këtu për të promovuar projekt ligjin e përgatitur "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Ky projekt ligj është hartuar në kuadrin e strategjisë së reformave që ka ndërmarrë qeveria për përsheptimin dhe përafrimin e legjislationit tonë me atë të komunitetit europian. Në këtë kuadër, projektligji që ju po merrni sot për ta studiuar e për të dhënë mendimet tuaja, është një përpjekje për një rregullim më të mirë ligjor lidhur me mbrojtjen e konsumatorit, me rregullimin e mbikqyrjen e tregut për pjesën e sigurimeve të detyrueshme, me krijimin e kushteve për realizimin e kërkesave dhe standarteve e marrëveshjeve për sistemin e kartonit jeshil, etj.

Ne kemi aktualisht një ligj që ka rregulluar këtë fushë të sigurimeve, i cili është hartuar në vitin 1992, mbi bazën e asaj përvoje e atyre kushteve që ekzistonin në atë kohë. Që nga ajo kohë, ashtu si në të gjitha fushat e veprimtarive ekonomike, shoqërore e kulturore, edhe në fushën e sigurimeve të detyrueshme, kanë ndodhur zhvillime të fuqishme, ç'ka bëjnë të domosdoshme ndërhyrjet në kuadrin ligjor rregullativ të këtij tregu.

Në kohën kur është miratuar ligji për sigurimet e detyrueshme, në Shqipëri ekzistonte vetëm një kompani siguruese, që ishte shtetërore. Sot në vendin tonë ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimeve të detyrueshme tetë kompani, nga të cilat shtatë janë plotësisht me kapital privat dhe vetëm një kompani, (INSIG-u) ka pjesëmarrje shtetërore. Vitet e fundit, në kuadrin e terrenit tejet lehtësues të krijuar si rezultat i politikave të Qeverisë për tërheqjen e investitorëve të huaj, shumë investitorë të fushës së sigurimeve, si Uniqua Group Austria, Vjena Insurance e Aspis Group, janë afruar dhe janë bërë bashkë financues në kompanitë shqiptare të sigurimit. Po kështu, është në proces shitja e kuotave shtetërore të INSIG-ut, c'ka ka nxitur investitorë të tjerë që kanë shprehur interes për futjen e investimeve për sigurime në Shqipëri. Ndjej për detyrë të përgëzoj e inkurajoj këta investitorë e të tjerë që do të vijjnë dhe t'ju uroj suksese në misionin e tyre.

Me projekt ligjin që po promovojmë sot, ne synojmë që të rregullojmë më mirë fushën e sigurimeve të detyrueshme, ku ndër momentet më kryesore mund të përmend:

- futjen e produkteve të reja të sigurimeve të detyrueshme, si për mjetet fluturuese (avionët), mjetet lundruese dhe sigurimin e pasagjerëve me mjetet e transportit publik;
- në projekt synohet liberalizimi i primeve të sigurimit;
- janë rishikuar limitet e përgjegjësisë, duke i përafëruar me ato të vendeve me kushte të përafërta me tonat, që janë ose aspirojnë që të jenë pjesë e Bashkimit Europian
- parashikohet e drejta e përfituesve që të kërkojnë dëmshpërblimin te siguruasi i drejtpërdrejtë, pra parashikohet që siguruasi mund të bëjnë marrëveshje me njëri - tjetrin për trajtimin e dëmeve për përfituesit e siguruar prej tyre.
- Parashikohet Qendra e Informacionit, me detyrimet e përgjegjësitë përkatëse
- Rregullohet më qartë funksionimi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe mënyra e krijimit e administrimit të Fondit të Kompesimit, Garancisë së Kartonit Jeshil dhe fondit për buxhetin e Byrosë
- Parashikohen procedura të qarta për trajtimin e pagesën e dëmeve, duke vendosur afate lidhur me trajtimin e dëmeve dhe ofrimin e shumave për dëmshpërblim.

- Synohet që shoqëritë e sigurimit të kenë statistika historike për klientët e tyre lidhur me ecurinë e kontratave të sigurimit të detyrueshëm, me qëllim aplikimin e primeve të diferencuara, sipas dëmeve që kanë shkaktuar (sistemi bonus-malus)
- Projekti parashikon Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, si autoritetin shtetëror që do të kujdeset për mbikqyrjen e mirëzbatimit të këtij ligji. Në ligjin aktual mbikqyrja e tij ushtrohet nga Ministri i Financave, kjo për faktin se sic përmenda më lart, në kohën e hartimit të atij ligji nuk ekzistonte një Autoritet Shtetëror i Pavarur, i specializuar i ngarkuar me mbikqyrjen e veprimtarive të sigurimit.
- Projekt ligji merr në konsideratë direktivat e Bashkimit European në fushën e sigurimeve të detyrueshme, si dhe është mbështetur në ligjet mbi sigurimet e detyrueshme të Kroacisë dhe Bullgarisë.M
- Ministria e Financave, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, do të mirëpresë çdo mendim e vërejtje lidhur me këtë projekt, me qëllim përmirësimin e tij, me synimin që brenda një afati sa më të shkurtër, të realizojmë të gjitha procedurat për miratimin e tij në Kuvend.

Edhe një herë, duke ju uruar punë të mbarë, ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim dhe gjithashtu ju falenderoj paraprakisht për kontributet që do të jepni për përmirësimin e projektit dhe për zbatimin korrekt të ligjit të ri.